



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 10, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 04/L -144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), të nenit 20, paragrafi 3, nënparagrafi 3.2 të Rregullores së QRK-së, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe të nenit 33.2, shkronja a dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.02.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM SHPI-KFOR-it, “FILM CITY”, NË PRISHTINË

- I.** MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim SHPI-KFOR-it, “Film City”, në Prishtinë, pa procedurë të rregullt konkurrimi.
- II.** Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: parcela nr. P-71914059-01498/75, në sipërfaqe prej 4520m², parcela nr. P-71914059-01498/79, në sipërfaqe prej 13575m², parcela nr. P-71914059-01504/5 në sipërfaqe prej 5325m² dhe parcela nr. P-71914059-01504/6, në sipërfaqe prej 14660m², Zona kadastrale Prishtinë.
- III.** Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është shfrytëzimi i pronës komunale për nevoja të KFOR-it.
- IV.** Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është afatshkurtër, në periudhën kohore për 10 (dhjetë) vjet.
- V.** Prona e paluajtshme e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI.** Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.

- VII.** Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.
- IX.** Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- kërkesa,
 - skica grafike,
 - fleta poseduese,
 - kopja e planit për parcelat kadastrale, nr. 1498/75, nr. 1498/79, nr. 1504/5 dhe nr. 1504/6, Zona kadastrale Prishtinë.
- X.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administratës të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
14-463/04-26666/19, më 06.02.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

